



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 9 tetor 2023  
Nr.ref.: RK 2283/23

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI52/23**

Parashtrues

**Nehat Publica**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, [Pml. nr. 16/2023], të 23 janarit 2023**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Nehat Publica, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 16/2023] e 23 janarit 2023 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i kontestuar) të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij, të garantuara me nenet: 3 [Barazia Para Ligjit], 21 [Parimet e Përgjithshme], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia Para Ligjit], 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 36 [E Drejta e Privatësisë], 37 [E Drejta e Martesës dhe Familjes], 38 [Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë], 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejme: Kushtetuta], në lidhje me nenet: 2 [E drejta për jetën], 3 [Ndalimi i torturës], 5 [E drejta për liri dhe siguri], 6 [E drejta për një proces të rregullt], 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare], 10 [Liria e shprehjes] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 7 shkurt 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 7 mars 2023, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI52/23 caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI52/23 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
8. Më 2 mars 2023, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, një kopje të kërkesës së parashtruesit iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 29 gusht 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Gjkata vëren se, parashtruesi i kërkesës i është drejtuar Gjykatës edhe në dy raste të tjera në të kaluarën. Në kërkesën e parashtruar në rastin e parë, KI149/21, më 19 gusht 2021, parashtruesi kishte pretenduar se zyrtarët policorë ushtruan dhunë fizike dhe psikike ndaj tij, në kohën e intervistimit në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Mitrovicë, dhe se mesazhet elektronike të publikuara nga ish-bashkëshortja përbënin cenim të privatësisë së tij. Më 10 nëntor 2021, Gjykata nëpërmjet Aktvendimit për papranueshmëri kishte vendosur se kërkesa e parashtruesit ishte e parakohshme, për shkak se legjislacioni në fuqi parashihte mjete efektive juridike përmes të cilave parashtruesi i kërkesës kishte mundur t'i realizonte të drejtat e tij ligjore dhe kushtetuese.
11. Gjykata vëren se, në kërkesën e dytë, KIO1/22, më 5 janar 2022, parashtruesi i kërkesës kontestonte Aktgjykimin [Ac. nr. 3609/2021] e 18 nëntorit 2021 të Gjykatës së Apelit, në ndërlidhje me Aktgjykimin [C. nr. 3709] e 8 shkurtit 2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sepse: (i) në cilësinë e të paditurit nuk ishte njoftuar nga Gjykata Themelore në lidhje me ushtrimin e padisë për zgjidhjen e martesës me shkurorezim nga ish-bashkëshortja, deri në mbajtjen e seancës dëgjimore më 8 shkurt 2020 dhe (ii) se ishte torturuar nga Policia e Kosovës, për shkak të kallëzimit penal të ushtruar ndaj tij, më 24 gusht 2020. Më 16 nëntor 2022, Gjykata nëpërmjet Aktvendimit për papranueshmëri vlerësoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës si qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese.

### **(i) Procedura penale nga hetimi deri te shqyrtimi gjyqësor**

12. Më 24 gusht 2020, shtetasja (M.H.), paraqiti ankesë në Policinë Rajonale në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: Policia), me pretendimin se parashtruesi i kërkesës e kishte kanosur atë nëpërmjet komunikimeve elektronike. Të njëjtën datë, Policia mori në pyetje parashtruesin e kërkesës, dhe me vendim të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore), iu caktua masa e ndalimit për 48 orë.
13. Më 25 gusht 2020, Policia parashtrroi kallëzim penal me numër [2020-BC-726], në Prokurorinë Themelore, kundër parashtruesit të kërkesës, sepse ekzistonte dyshimi i bazuar se ky i fundit i kishte dërguar mesazhe të ndryshme bashkëshortes së tij me të cilat e kishte kanosur, dhe me këto veprime kishte kryer veprën penale “Kanosja” nga neni 181, paragrafi 4 i KPRK-së dhe “Dhuna në familje” nga neni 248, paragrafi 1 i KPRK-së.
14. Më 25 gusht 2020, Prokuroria Themelore nxori Aktvendimin [PP. II. nr. 1197/2020] për fillimin e hetimeve ndaj parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se ai kishte kryer veprën penale “Ngacmimi” dhe “Dhuna në Familje”. Të njëjtën datë, Prokuroria Themelore paraqiti kërkesë [PP. II. nr. 1197/2020] në Gjykatën Themelore në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), për caktimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës.
15. Më 26 gusht 2020, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktvendimit [GJPP. nr. 266/20] refuzoi kërkesën e Prokurorisë Themelore për caktimin e paraburgimit, dhe ndaj parashtruesit të kërkesës caktoi masën e ndalimit të ofrimit me të dëmtuarën.
16. Më 21 shtator 2020, Prokuroria Themelore ngriti aktakuzën [PP. II. nr. 1197/20] pranë Gjykatës Themelore, kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të veprës penale “Ngacmimi”, sipas nenit 182, paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së. Prokuroria Themelore, ndër të tjera, pretendonte që:

*“... në disa raste në muajin e fundit gati për çdo ditë e deri më 21.08.2020 në Mitrovicë, në mënyrë të vazhdueshme dhe të padëshirueshme e ka tërheqjen vëmendjen kah vetja dhe me këtë rast e ka sjellë të dëmtuarën M.H. në gjendje të vuajtjes së rëndë shpirtërore, në atë mënyrë që çdo ditë i ka dërguar SMS porosi të dëmtuarës, si dhe anëtarëve të familjes së saj, edhe pse e dëmtuara – bashkëshortja e tij e ka braktisur dhe është kthyer te prindërit, si dhe ka filluar procesi i shkurorëzimit, e më këtë ka shkaktuar frikë dhe ngacmim te e njëjta”.*

17. Më 11 nëntor 2020, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kundërshtim ndaj provave të paraqitura dhe kërkesë për hedhje të aktakuzës. Gjithashtu, ai kërkoi që Gjykata Themelore të shpallej si jokompetente në aspektin territorial. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se provat ishin nxjerrë pa urdhër të gjykatës prandaj ato janë të papranueshme.
18. Më 6 janar 2021, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktvendimit [P. nr. 664/20], e refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhje të aktakuzës të parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore konsideroi që provat e grumbulluara ishin bazë e mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se parashtruesi i kërkesës kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej, dhe se mesazhet e publikuara nga e dëmtuara nuk përbëjnë cenim të privatësisë. Nëpërmjet këtij aktvendimi, u refuzua edhe kërkesa e parashtruesit të kërkesës që Gjykata Themelore të shpallej jo kompetente në aspektin territorial.
19. Më 25 shkurt 2021, Inspektorati Policor i Kosovës pranoi ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj zyrtarëve policorë, dhe e regjistroi me numër: [IPK/DMA/1188/21] dhe referencë [03-116-1697/5].
20. Parashtruesi i kërkesës brenda afatit ligjor ushtroi ankesë kundër Aktvendimit [P. nr. 664/20] të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, të ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.
21. Më 8 mars 2021, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktvendimit [Pn.nr. 181/2021], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Gjykata e Apelit arsyetoi se aktakuza mbështetet në prova të mjaftueshme dhe ekziston dyshimi i bazuar për kryerjen e veprës penale.

#### **(ii) Aktgjykimet e gjykatave të rregullta**

22. Më 16 shkurt 2022, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktgjykimit [P. nr. 664/20], shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak të veprës penale “Ngacmimi”, dhe i shqiptoi dënimin me kusht me 6 (gjashtë) muaj burgim. Gjykata Themelore, ndër të tjera, arsyetoi si në vijim:

*“Në vështrim të marrëdhënies psikike të të pandehurit ndaj veprës penale të kryer, Gjykata ka gjetur se i pandehuri në momentin kritik ka vepruar me dashje direkte, gjegjësisht me qëllim që ta ngacmojë, ta frikësojë apo ta lëndojë të dëmtuarën – ish-gruan e tij, e ka vënë në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme andaj gjykatave për veprën e përmendur penale e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar sipas ligjit”.*

*“Pasi që në procedurë nuk është përmendur asnjë rrethanë me të cilën do të vihej në pyetje vetëdija e të pandehurit në kohën e kryerjes së veprës penale, gjykata ka përfunduar se bëhet fjalë për kryerës të vetëdijshëm dhe se ai ka vepruar me dashje*

*direkte si formë e fajësisë, ka qenë i vetëdijshëm se vepra e tij është e ndaluar, i vetëdijshëm për veprimet e veta dhe se ka dashur kryerjen e saj”.*

23. Parashtruesi i kërkesës brenda afatit ligjor dorëzoi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit [P. nr. 664/20] të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal.
24. Më 15 shtator 2022, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktgjykimit [PA1. nr. 597/2022], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [P. nr. 664/20] e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, arsyetoi si në vijim:  
*“Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sa i përket shkeljes së ligjit penal, për të cilat shkelje kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394, par.1 pika 1.4 të KPPK-së, sipas ankesës së ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, të parapara në nenin 385 të KPPK-së, sepse gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejta ka vlerësuar të gjitha provat, të cilat karakterizojnë veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, e posaçërisht ka vërtetuar se nga veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale ngacmimi nga neni 182, par.2 lidhur me par. 1 të KPK-së, ashtu që në veprimet e të akuzuarit janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë, dhe se e njëjta është e paraparë me ligjin e aplikueshëm, i cili është aplikuar në kohën e kryerjes së veprës penale nga ana e të akuzuarit, gjithashtu nuk ka gjetur se ka prova të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale për të akuzuarin, si dhe ndjekjen penale, e gjithashtu gjykata e shkallës së parë, ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, andaj edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet në shkelje të ligjit penal sikurse pretendohet në ankesën e ushtruar”.*
25. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe ligjit penal. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Supreme që t'i anulonte aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit, dhe çështja të kthehej në rivendosje.
26. Më 23 janar 2023, Gjykata Supreme nëpërmjet Aktgjykimit [Pml. nr. 16/2023], refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi si në vijim:

*“Nuk qëndron pretendimi i të dënuarit se aktgjykimi i kundërshtuar është bazuar në prova të papranueshme, për faktin se provat e proceduara sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë marrë në mënyrë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, por përkundrazi janë të ligjshme dhe dihet origjina dhe burimi i tyre, të njëjtat në asnjë fazë të mëhershme nuk janë shpallur si prova të papranueshme. Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ka vendosur kur të dënuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale që vihej në barrë, sepse nga të gjitha provat e administruara dhe vlerësuar, sikurse janë deklarata e të dëmtuarës M. H. foto dokumentacioni dhe regjistri i mesazheve-SMS të dërguara, gjykata drejt ka vërtetuar se i dënuari e ka kryer veprën penale ngacmimi nga neni 182, par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, prandaj edhe pretendimi se është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit është i pabazuar”.*

*“Sipas dispozitës së nenit 385, par.5 të KPPK-së, kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënimin,*

dënimin alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm, për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkuluar kompetencat ligjore. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar rrethanat lidhur më dënimin, përmes individualizimit të dënimin të dënuarit i ka shqiptuar dënimin brenda kufijve të paraparë për këtë vepër penale, pra nuk janë tejkuluar kompetencat ligjore”.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon që akti i kontestuar, ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet: 3 [Barazia Para Ligjit], 21 [Parimet e Përgjithshme], 23 [Dinjteti i Njeriut], 24 [Barazia Para Ligjit], 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor Ose Poshtëruar], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 36 [E Drejta e Privatësisë], 37 [E Drejta e Martesës dhe Familjes], 38 [Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë], 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës, në lidhje me nenet: 2 [E drejta për jetën], 3 [Ndalimi i torturës], 5 [E drejta për liri dhe siguri], 6 [E drejta për një proces të rregullt], 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare], 10 [Liria e shprehjes] të KEDNJ-së.

### **Pretendimet për shkeljen e nenit 27 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së:**

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, “Jam torturuar poshtëruar nga policët në stacionin policor të Mitrovicës me fjalët më të rënda ofenduese”. “Në këtë nen unë mbështetem sepse mos të kishin ndërhyrë persona tjerë aty unë do të isha torturuar nga policia deri në vdekje ku dhuna psikike është e pariparueshme”.

### **Pretendimet për shkeljen e nenit 29 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së**

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, “Jam ndaluar pa asnjë arsye dhe ndalimi nuk më është sqaruar dhe urdhër ndalimi ka ardhur në gjuhën serbe që unë nuk e kuptoj, ndalimi është bërë pas dhunës që është përdorur nga policia ku jam detyruar të nënshkruaj dokumentin e ndalimit”. Parashtruesi po ashtu thekson se, “Janë përdorur metoda poshtëruese e dhunuese gjatë ndalimit deri në kërcënime me jetë nga personat zyrtarë policorë, ku të gjitha faktet janë të paraqitura edhe tek Avokati i Popullit dhe në media elektronike”.

### **Pretendimet për shkeljen e nenit 30 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së**

30. Në lidhje me shkeljen e nenit 30, parashtruesi i kërkesës pretendon se, “Nuk më është ofruar asnjë e drejtë minimale gjatë ndalimit, po ashtu jam shtrënguar dhunuar nga policët që të bëjë deklaratë nën dhunë fizike, psikike, më janë ndaluar gjësendet e mija personale, siç ishin çelësat e veturës kur nuk ua kanë dhënë familjarëve të mi kur kanë ardhur me i marrë dhe vetura më ka mbetur për dy ditë në parking”.
31. Parashtruesi i kërkesës thekson se, “Të drejtat e mija janë shkelur prej momentit që më është montuar rasti nga policët dhe prokuroria e Mitrovicës për dhunë në familje pa pasur asnjë fakt, po ashtu mohimi i përdorimit të mjeteve juridike, siç është kërkesa për avokat, ku jam dhunuar fizikisht, psikikisht, nga policët se unë e kam kërkuar një të drejtë timen që më garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe tek pas këtyre maltretimeve një orëshe dhe vendimit për ndalim është ftuar avokati kur edhe avokati

*nuk ka ndërhyrë edhe pse i kam treguar për audio incizimet që i kam pasur”. “Jam ofenduar, sharë, maltretuar vetëm pse kërkoja të drejtën time për mbrojtje”.*

### **Pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 dhe 8 të KEDNJ-së**

32. Parashtruesi i kërkesës thekson se, *“Nuk mund të ketë gjykim të drejtë në atë vend ku është përdorur dhuna fizike, ku edhe gjyqtari është caktuar në kundërshtim me ligjin sepse banon në të njëjtin vend me ish- bashkëshorten. Por, lidhjet familjare ndërmjet gjykatës dhe personave të jashtëm ka qenë i faktuar dhe në shumë sjellje të këtyre gjyqtarëve ku edhe është larguar gjyqtari R.B. pas ankesës sime ku është vendosur një gjyqtare tjetër në rast D.B”.* Gjithashtu, ai thekson se, *“Procesi ka pasur parregullsi që nga Prokuroria deri tek Gjykata Themelore Mitrovicë, ku ka pasur ndërhyrje nga palët tjera jashtë gjykatës dhe ka ardhur deri te kërkesa ime për përjashtimin e gjyqtarit R.B., i cili pas ankesës sime dhe kërkesës që e kam bërë është ndryshuar gjyqtari edhe pse në atë Gjykatë ka pasur shkelje të shumta ku Gjykata e Apelit nuk i ka marrë parasysh pretendimet e mia. Gjykata e Apelit në dy ankesat ka vendos i njëjti gjyqtar për të njëjtin rast”.*
33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, *“Momentin e arrestimit dhe publikimit të sms kontaktit me ish-bashkëshorten janë shkelur të drejtat e komunikimit familjar ku nuk ka pasur asnjë vendim nga prokuroria as gjykata për nxjerrjen dhe pranimin e atyre sms-ve”. “Mesazhet që i ka paraqitur prokurorja janë pranuar printuar në mënyrë të jashtëligjshme dhe kështu më është shkelur e drejta ime private e komunikimit me ish-bashkëshorten”.*

### **Pretendimet e tjera**

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu se, *“Këtu nuk jam duke u trajtuar i barabartë para ligjit sepse prokurorja nuk më ka intervistuar asnjëherë. Diskriminimi në bazë të gjinisë është duke ndodhur në rastin tim sepse këtu është duke i dhënë përparësi gjinisë tjetër pa pasur asnjë fakt mbi akuzat që më ngarkohen, po ashtu faktet e paraqitura nuk janë pranuar nga Prokuroria dhe gjykata asnjëherë me arsyetimin se unë jam i akuzuar”.*
35. Parashtruesi i kërkesës thekson se, *“Akuzat ndaj meje nga Dhuna në Familje në Ngacmim që për asnjëherë s’ ka pas asnjë fakt tregon edhe njëherë se Prokuroria ka qenë nën ndikim të njerëzve të jashtëm me sms, mendoj se është në kundërshtim me këtë nen të Kushtetutës dhe në kundërshtim me ligjin për familje në Kosovë”. Ai po ashtu shkruan se, “Më është cenuar e drejta e lirisë së besimit për sms që i kam shkruar bashkëshortes me fjalë të besimit që jam mysliman me pyetje provokuese”. “Në komunikimin me sms aty tentohen nga prokuroria dhe gjykata të më mohohet liria e shprehjes”. “Shprehja Bele është marrë si vepër penale e cila nuk përkon me realitetin dhe është shkelje e fjalës së lirë”.*

### **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

#### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

##### **Neni 23**

##### **[Dinjiteti i Njeriut]**

*Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.*

##### **Neni 27**

**[Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruës]**  
Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës

### **Neni 29**

#### **[E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]**

Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

- (1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;
  - (2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjyqimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;
  - (3) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;
  - (4) për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;
  - (5) për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim.
- [...]

### **Neni 30**

#### **[Të Drejtat e të Akuzuarit]**

Çdokush që akuzohet për veprë penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

- (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;
- (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;
- (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
- (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;
- (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;
- (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.

### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për veprë penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për veprë penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.



[...]

### **Neni 36**

#### **[E Drejta e Privatësisë]**

1. Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.
2. Kontrollat e cilësdo banesë ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratoj veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.
3. Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.
4. Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj.

## **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

### **Neni 6**

#### **(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

### **Neni 3**

#### **[Ndalimi i torturës]**

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

## **KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

### **Neni 182**

#### **[Ngacmimi]**

1. Kushdo që përfshihet në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ose komunikon me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmeve apo kafshëve shtëpiake ose kushdo që vë tjetrin nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmeve apo kafshëve shtëpiake; dhe gjatë këtyre veprimeve vë atë person nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndimi i rëndë trupor,

dëmtimi i rëndë i pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj një personi me të cilin kryesi ka qenë apo është në marrëdhënie familjare ose ndaj një ish-anëtari apo anëtari aktual të familjes, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

[...]

## KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE

### KAPITULLI XVII

#### PROVAT

##### Neni 251

#### [Rregullat e përgjithshme për prova]

1. Rregullat e provës të parapara në këtë nen zbatohen në të gjitha procedurat penale para gjykatës dhe, në rastet kur e parasheh ky Kod, ato gjithashtu zbatohen në procedurat para Prokurorit të Shtetit dhe policisë.

2. Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu.

3. Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme.

4. Gjatë çdo intervistimi ose marrjeje në pyetje ndaloheq që:

4.1. liria e të pandehurit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij të ndikohet nëpërmjet keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit;

4.2. i pandehuri të kanoset me masa të ndaluara me ligj;

4.3. të premtohet ndonjë përfitim që nuk parashihet me ligj; dhe

4.4. të dobësohet kujtesa e të pandehurit ose aftësia e tij për të kuptuar

5. Ndaj nga paragrafi 4 i këtij neni zbatohet pavarësisht nga pëlqimi i personit të intervistuar ose të marrë në pyetje.

6. Kur intervistimi ose marrja në pyetje është zbatuar në kundërshtim me paragrafin 4. të këtij neni, procesverbali i intervistimit ose marrjes së tillë në pyetje është i papranueshëm.

#### Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

36. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

##### Neni 113

#### [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

##### Neni 21

#### [Parimet e përgjithshme]

[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

38. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

39. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ai konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 16/2023], të 23 janarit 2023 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
40. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me nënrregullin (2), të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 39

[Kriteret e pranueshmërisë]

(2) “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk e mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

[...]

41. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, këtyre pretendimeve është më e saktë t’u referohemi si “pretendime qartazi të pabazuara”, të cilat bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”;

(iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të KEDNJ-së apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GjEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” (shih, rastet e GjEDNJ-së, [Kemache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).

42. Gjykata vëren se, pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës lidhen me faktin që me aktin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet: 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 5 [E drejta e lirisë dhe sigurisë] dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të KEDNJ-së.
43. Në këtë kontekst, Gjykata do t'i shqyrtojë dhe analizojë këto pretendime, në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNJ), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, gjykatat e rregullta dhe Gjykata Kushtetuese është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

**i. Sa i përket pretendimeve për shkeljen e nenit 27 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së**

44. Gjykata përsërit se praktika e GJEDNJ-së, për qëllime të nenit 3, ka përkufizuar se KEDNJ-ja edhe në rrethanat më të vështira, si lufta kundër terrorizmit dhe krimin të organizuar, në mënyrë absolute e ndalon torturën, trajtimin çnjerëzor ose degradues, pavarësisht sjelljes së viktimës. Sipas GJEDNJ-së, trajtimi çnjerëzor është pranuar si degradues vetëm atëherë kur viktimave u është shkaktuar qëllimshëm ndjenja e frikës, ankthit ose inferioritetit, poshtërimit dhe përluljes, thyerjes së qëndrueshmërisë fizike ose morale, ose kur ashpërsia e keqtrajtitit e nxitë viktimën të veprojë kundër vullnetit ose vetëdijes së tij/saj (shih rastin [Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 27229/95, para. 120, GJEDNJ 2001-III, dhe [Ramirez Sanchez kundër Francës](#), nr. 59450/00, para. 118, GJEDNJ 2006-IX).
45. Sipas GJEDNJ-së, në mënyrë që keqtrajtimi të bie brenda fushëveprimit të nenit 3 të KEDNJ-së, ai duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie. Vlerësimi i këtij niveli do të varet nga të gjitha rrethanat e rastit si kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike ose mendore, kurse në disa raste merret në konsideratë edhe gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës. Gjykata rikujton se pretendimet për keqtrajtim duhet të mbështeten me prova dhe se vlerësimi i tyre duhet të karakterizohet përtej dyshimit të arsyeshëm (shih rastin e GJEDNJ-së, *Gok dhe Guler kundër Turqisë*, nr. 74307/01, 28

korrik 2009; shih rastin e Gjykatës [KI82/16](#), parashtrues *Deljalj Kazagić*, Aktvendim për papranueshmëri i 1 marsit 2017, para. 35-37).

46. Parashtruesi i kërkesës pretendon se zyrtarët policorë ushtruan dhunë fizike dhe psikike ndaj tij, në kohën kur u intervistua nga ata në Drejtorinë Rajonale të Policisë.
47. Duke iu referuar fakteve të rastit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar në Inspektoratin Policor të Kosovës ankesë ndaj zyrtarëve policorë. Inspektorati Policor njoftoi parashtruesin e kërkesës se ankesa e tij ishte proceduar në Drejtorinë e Hetimeve të Brendshme dhe Verifikim të Policisë së Kosovës, për hetime të mëtutjeshme disiplinore. Gjykata vëren se në dosjen e lëndës nuk ka ndonjë informacion nëse Inspektorati Policor ose organet kompetente të kenë marrë ndonjë vendim në lidhje me këtë çështje.
48. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës për të mbështetur pretendimet e tij për ushtrim të dhunës fizike ka paraqitur disa evidenca në lidhje me vizitat mjekësore që kishte zhvilluar. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të argumentojë nëse agjentët policorë kishin ushtruar dhunë fizike dhe psikike ndaj tij, dhe se evidencat e paraqitura nga ai nuk mbështesin ndonjë pretendim të tillë.
49. Nga arsyet e shtjelluara sa më sipër, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës të garantuar me nenin 27 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “të pambështetura apo të paarsyetuara”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese këto pretendime duhet shpallur qartazi të pabazuara.

## **ii. Sa i përket pretendimeve për shkeljen e nenit 29 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së**

50. Gjykata rikujton se, GJEDNJ-ja ka trajtuar dhe sqaruar rëndësinë e të drejtës për liri dhe siguri në një shoqëri demokratike, raportet me parimin e sigurisë juridike dhe sundimin e ligjit, duke specifikuar se qëllimi i përgjithshëm i të drejtës për liri dhe siguri është që të sigurohet që askujt të mos mund t'i kufizohet liria në mënyrë arbitrare. (Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 13 dhjetorit 2013, [El-Masri kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë](#), nr. 39630/09, paragrafi 230).
51. Gjykata rikujton se, në bazë të praktikës së GJEDNJ-së, dy parimet kryesore që duhet të merren parasysh në interpretimin e të drejtës së lirisë dhe sigurisë, janë: parimi i ligjshmërisë dhe parimi i mbrojtjes nga arbitrariteti. Sipas GJEDNJ-së, parimi i ligjshmërisë nënkupton respektimin e rregullave materiale dhe procedurale të përcaktuara nga legjislacioni nacional. Neni 5 i KEDNJ-së në lidhje me nenin 29 të Kushtetutës kërkon, për më tepër, që çdo heqje e lirisë duhet të respektoj qëllimin e mbrojtjes nga arbitrariteti. (Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, [Ladent kundër Polonisë](#), nr.11036/03, i 18 qershorit 2008, paragrafi 48; shih rastin e Gjykatës [KI63/17](#), parashtrues *Lutfi Dervishi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 tetorit 2017, para. 47-58; shih rastin e Gjykatës [KI10/18](#), parashtrues *Fahri Deqani*, Aktgjykim i 8 tetorit 2019, para. 65/68; rasti i Gjykatës [KI07/22](#), parashtrues *Miljan Koshanin*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 qershorit 2022, para. 49-51).
52. “Dyshimi i bazuar” mbi të cilin bazohet arrestimi, përbën një element kryesor kundër arbitraritetit në rastet e arrestimit apo paraburgimit siç përcaktohet nga KEDNJ-ja. “Dyshimi i bazuar” presupozon ekzistencën e fakteve apo të informatave që do të bindnin një vëzhgues objektiv që personi në fjalë mund të ketë kryer veprën për të cilën akuzohet. (shih rastin e GJEDNJ-së, [Stepuleac kundër Moldavisë](#), Aktgjykim i 6

nëntorit 2007, nr. 8207/06, paragrafi 68; shih rastin e Gjykatës [KI88/22](#), parashtrues *Nexhat Konushevc*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 shtatorit 2022, para. 63-67).

53. Duke iu referuar shkresave të rastit, Gjykata vëren se më 24 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës u denoncua në polici nga ish-bashkëshortja e tij, për shkak se kjo e fundit ndihej e kërcënuar nga mesazhet elektronike që i pranonte nga ai. Menjëherë pas denoncimit, autoritetet policore morën në pyetje parashtruesin e kërkesës në lidhje me pretendimet e bashkëshortes së tij, dhe me vendim të Prokurorisë Themelore iu caktua masa e ndalimit për 48 orë.
54. Gjykata vëren se më 25 gusht 2020, Policia paraqiti kallëzim penal në Prokurorinë Themelore kundër parashtruesit të kërkesës, me pretendimin se i njëjti kishte kryer veprën penale “Ngacmimi” dhe “Dhuna në Familje” sipas KPRK-së. Të njëjtën datë, Prokuroria Themelore mori vendim për fillimin e hetimeve, dhe kërkoi nga Gjykata Themelore caktimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore dhe e Apelit refuzuan kërkesën e Prokurorisë Themelore për caktimin e paraburgimit, dhe ndaj parashtruesit të kërkesës caktuan masën e ndalimit të afërimit me të dëmtuarën.
55. Duke u bazuar në shkresat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës u ndalua nga autoritetet kompetente për shkak të dyshimit të bazuar se ai kishte kryer një veprë penale. Gjithashtu, masa e ndalimit për 48 orë u zbatua nëpërmjet vendimit të Prokurorisë Themelore. Pas kësaj, parashtruesi i kërkesës u lirua me vendim të gjykatave të rregullta, të cilat vlerësuan se masa e paraburgimit nuk ishte e përshtatshme, dhe në vend të saj ndaj parashtruesit të kërkesës caktuan masën e ndalimit të afërimit me të dëmtuarën.
56. Gjykata vlerëson se autoritetet kompetente vepruan në përputhje me procedurat ligjore të përcaktuara për rastet e tilla, dhe se nuk bëhet fjalë për kufizim arbitrar të së drejtës së lirisë dhe sigurisë ndaj parashtruesit të kërkesës. Gjykata vlerëson se veprimet procedurale të marra nga autoritetet përkatëse, në lidhje me ndalimin e parashtruesit të kërkesës, ishin në përputhje me kërkesat dhe qëllimet e nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së.
57. Nga arsyet e shtjelluara sa më sipër, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës për liri dhe siguri, të garantuar me nenin 29 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese këto pretendime duhet shpallur qartazi të papabuzuara.

### **iii. Sa i përket pretendimeve për shkeljen e nenit 30 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së**

58. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, gjatë ndalimit në stacionin policor nuk iu ofrua asnjë e drejtë minimale, dhe që zyrtarët policorë ushtruan dhunë fizike dhe psikike ndaj tij dhe në këtë mënyrë e detyruan që të jepte deklaratë.
59. Duke iu referuar shkresave të rastit, përkatësisht procesverbalit mbi marrjen në pyetje të dyshuarit [2020-BC-726], të 24 gushtit 2020, Gjykata vëren se autoritetet policore morën në pyetje parashtruesin e kërkesës në lidhje me veprën penale për të cilën dyshohej se e kishte kryer. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës u njoftua për të gjitha të drejtat e tij ligjore: u njoftua për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij; për të drejtën për të heshtur dhe për të mos e fajësuar veten, dhe as të afërimit e tij; për të drejtën e caktimit të një avokati, dhe të konsultimit me të; për të drejtën e përkthyesit,

në rast se kishte nevojë. Parashtruesit të kërkesës iu caktua avokati mbrojtës sipas detyrës zyrtare, dhe në praninë e tij u intervistua nga zyrtarët policorë. Gjykata vëren se, në fillim të intervistimit parashtruesi i kërkesës deklaroi se ishte njoftuar për të drejtat e tij ligjore, ndërsa në fund nënshkroi procesverbalin e lartpërmendur.

60. Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk argumenton me asnjë provë pretendimet e tij në lidhje me mohimin e të drejtave ligjore dhe kushtetuese gjatë ndalimit në stacionin policor, dhe marrjes në pyetje. Gjykata vëren se autoritetet kompetente vepruan në përputhje me kërkesat dhe qëllimet e nenit 30 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe asesi nuk bëhet fjalë për cenim të të drejtave kushtetuese të të akuzuarit.
61. Nga arsyet e shtjelluara sa më sipër, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës të garantuar me nenin 30 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “të pambështetura apo të paarsyetuara”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese këto pretendime duhet shpallur qartazi të pabazuara.

#### **iv. Sa i përket pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 dhe 8 të KEDNJ-së**

62. Gjykata rithekson se, sipas GJEDNJ-së, “Ndonëse neni 6 e garanton të drejtën për një proces të rregullt, ai megjithatë nuk përcakton rregulla për pranueshmërinë e provave, një fushë kjo që u përket për këtë arsye në radhë të parë të drejtës së brendshme dhe juridiksioneve kombëtare” (shih rastin e GJEDNJ-së, [Schenk kundër Zvicrës](#), nr.10862/84, Aktgjykim i 12 korrikut 1988, paragrafët 45-46).
63. Megjithatë, sipas GJEDNJ-së, aspekti që duhet shqyrtuar në këto raste është nëse procedurat, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë mbledhur provat, ka qenë e rregullt në tërësinë e saj (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 35394/97, Aktgjykim i 12 majit 2000, para. 34; [P.G e J.H kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 44787, Aktgjykim i 25 shtatorit 2001, para 76; [Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 48539/99, Aktgjykim i 5 nëntorit 2002, para. 42).
64. Në mënyrë që të bëhet vlerësimi nëse procedura ishte e drejtë në tërësi, fillimisht duhet pasur parasysh nëse janë respektuar të drejtat e mbrojtjes. Në lidhje me këtë, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës kishte mundësi ta kontestojë ligjshmërinë e provave dhe të kundërshtoj përdorimin e tyre para gjykatave të rregullta (shih rastin e Gjykatës [KI34/18](#), parashtrues [Albert Berisha](#), Aktvendim për pranueshmëri, i 23 majit 2018, para. 63). Gjithashtu, duhet marrë parasysh cilësia e provave, rrethanat nën të cilat janë marrë ato, si dhe nëse këto rrethana ngrenë dyshime në lidhje me besueshmërinë dhe saktësinë e provave. Këto vlerësime duhen bërë edhe në rastet kur, çështja në fjalë lidhet me pretendimet se përdorimi si provë i informatave që bien ndesh me nenin 8 të KEDNJ-së, e bëjnë procesin gjyqësor të padrejtë në tërësi. Për shembull, në rastet kur provat janë marrë nga masat e fshehta dhe të paligjshme të vëzhgimit (rasti i GJEDNJ-së, [Bykov kundër Ruisisë](#), nr. 4378/02, Aktgjykim i 10 marsit 2009, para. 69-83; [Dragojević kundër Kroacisë](#), nr. 68955/11, Aktgjykim i 15 prillit 2015, para. 127-135).
65. GJEDNJ ka theksuar se kur prova është shumë e qëndrueshme dhe nuk vihet fare në dyshim, nevoja për prova të tjera në mbështetje të saj bëhet më e vogël. Sipas GJEDNJ-së, duhet kushtuar rëndësi çështjes nëse prova në fjalë ka qenë apo jo përcaktuese për rezultatin e procesit penal (shih rastet e GJEDNJ-së, [Bykov kundër Ruisisë](#), nr. 4378/02, Aktgjykim i 10 marsit 2009, para. 89; [Jalloh Kundër Gjermanisë](#), nr.

54810/00, Aktgjykim i 11 korrikut 2006, para. 96; *Gafgen kundër Gjermanisë*, nr. 22978/05, Aktgjykim i 1 qershorit 2010, para. 164; shih rastin e Gjykatës [KI17/22](#) dhe [KI22/22](#), parashtrues *Hazir Krasniqi dhe Durim Krasniqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 dhjetorit 2022, para. 108-111; rasti i Gjykatës [KI122/19](#), parashtrues *F. M.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 korrikut 2020, para. 66-69).

66. Gjykata rikujton se, nuk është detyrë e saj që të vlerësojë konkluzionet e arritura nga gjykatat e rregullta në lidhje me vlerësimin e provave, përveç nëse ato janë qartazi arbitrare. Gjykata nuk ndërhyr në mënyrën se si gjykatat e rregullta kanë pranuar provat si material dëshmuës e as nuk ndërhyr në diskrecionin e gjykatave të rregullta në peshimin e provave, ngase kjo është detyrë e gjykatave të rregullta. (shih rastin e Gjykatës [KI13/16](#), parashtrues *Armend Selimi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2016, paragrafi 42, 46).
67. Gjykata rithekson se detyra e saj është që të vlerësojë nëse procedurat përkatëse të gjykatave të rregullta ishin të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, si dhe nëse ato procedura kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih rastin e Gjykatës [KI10/15](#) dhe [KI12/15](#), parashtrues *Shpresim Uka dhe Besim Uka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 majit 2016, para. 35).
68. Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta e shpallën atë fajtor mbi bazën e mesazheve të cilat ishin printuar në mënyrë të jashtëligjshme, në kundërshtim me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] të KEDNJ-së. Siç është elaboruar më lart, Gjykata do të vlerësojë nëse provat e administruara në rastin konkret, mesazhet elektronike, e kanë bërë procesin gjyqësor të padrejtë në tërësi, në kundërshtim me qëllimet e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor.
69. Duke iu referuar fakteve të rastit, Gjykata vëren se më 11 nëntor 2020, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kundërshtim ndaj provave të paraqitura dhe bëri kërkesë për hedhje të aktakuzës. Sipas pretendimit të parashtruesit, publikimi i mesazheve elektronike nuk ishte bërë mbi bazën e një urdhri të gjykatës, dhe rrjedhimisht provat e tilla duhet të ishin shpallur të papranueshme.
70. Gjykata vëren se, Gjykata Themelore hodhi poshtë kundërshtimin e provave të ngritura nga parashtruesi dhe arsyetoi se provat e tilla, mesazhet elektronike, mund të publikoheshin pa pasur nevojë për masa të fshehta të vëzhgimit, dhe se të njëjtat ishin paraqitur nga bashkëshortja e tij në cilësinë e të dëmtuarës. Të njëjtin qëndrim e mbajti edhe Gjykata e Apelit, e cila duke vendosur në lidhje me ankesën e parashtruesit të kërkesës, arsyetoi se provat e paraqitura nuk ishin marrë në mënyrë të kundërligjshme, dhe si të tilla ato duhej të trajtoheshin në shqyrtimin gjyqësor.
71. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta shqiptuan dënimin me kusht, me 6 (gjashtë) muaj burgim ndaj parashtruesit të kërkesës, për veprën penale “Ngacmimi” sipas KPRK-së, mbi bazën e provave të administruara - mesazheve elektronike, të paraqitura nga denoncuesja - bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës, në cilësinë e viktimës.
72. Gjykata thekson se sikurse që është elaboruar më sipër te parimet e përgjithshme, kur pretendohet për administrim të gabuar të provave, kjo gjë duhet vlerësuar nëse procedurat e ndjekura në lidhje me mbledhjen e tyre ishin të drejta në tërësi. Gjykata rikujton se është detyrë e gjykatave të rregullta të administrojnë provat, të vendosin për pranueshmërinë e tyre, dhe krejt në fund t’i peshojnë ato sipas rëndësisë që kanë. Gjykata mund të ndërhyjë vetëm atëherë kur procedurat në lidhje me administrimin e provave rezultojnë të jenë arbitrare, deri në masën që mund të kenë cenuar të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja.



73. Duke iu referuar fakteve të rastit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte pasur mundësi të kontestoj ligjshmërinë e provave gjatë procedurës gjyqësore të zhvilluar ndaj tij. Megjithatë, gjykatat e rregullta vlerësuan se provat e paraqitura ishin të ligjshme, dhe kishin peshë të mjaftueshme për të mbështetur akuzën penale ndaj parashtruesit të kërkesës.
74. Gjykata vlerëson se mesazhet elektronike që u përdorën si prova kryesore kundër parashtruesit të kërkesës, nuk ishin marrë nëpërmjet ndonjë teknike të vëzhgimit, apo duke cenuar të dhënat personale të telefonit të tij, që do të mund të kishte rezultuar me shkeljen e të drejtave të tij nga neni 36 i Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së. Gjykata vlerëson se në rastin konkret, ish-bashkëshortja e parashtruesit, në cilësinë e viktimës, kishte njoftuar autoritetet për ngacmimet e shpeshta të parashtruesit të kërkesës në drejtim të saj. Në këtë kuptim, mesazhet e shfaqura nga ajo shërbyen si prova për të mbështetur akuzën penale ndaj parashtruesit të kërkesës. Gjykata vlerëson se nuk bëhet fjalë për shkelje të së drejtës private të parashtruesit të kërkesës, dhe se, administrimi i provave nuk kishte shkelur rregullsinë e procesit gjyqësor. Gjykata thekson se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për administrim arbitrar të provave, dhe se gjykatat e rregullta nuk kishin cenuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për një proces të rregullt gjyqësor.
75. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e procesit të rregullt gjyqësor, edhe për faktin që, sipas tij, gjykatat e rregullta gabimisht kishin vendosur në lidhje me kompetencën territoriale të tyre, dhe në rastin konkret, kompetencë territoriale kishte Gjykata Themelore në Prishtinë dhe jo ajo në Mitrovicë. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon që caktimi i gjyqtarit në çështjen e tij ishte caktuar në kundërshtim me ligjin.
76. Gjykata përsërit se nuk është detyrë e saj që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i këtyre të fundit është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Nuk është detyrë e gjykatës që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç nëse ato i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga Kushtetutë dhe KEDNJ-ja (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr.30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999; rasti i Gjykatës [KI192/13, parashtrues Hatixhe Avdyli](#), Aktvendim i 24 shkurtit 2014).
77. Gjykata vlerëson se, përcaktimi i kompetencës territoriale në një procedurë gjyqësore është përgjegjësi dhe detyrë e gjykatave të rregullta, të cilat e interpretojnë të drejtën procedurale dhe materiale në çdo rast. E njëjta gjë vlen edhe për caktimin e gjyqtarëve në rastet konkrete. Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk argumenton shkeljet e pretenduara kushtetuese, përveç se i përmend dhe i citon dispozitat e caktuara të Kushtetutës dhe KEDNJ-së.
78. Nga arsyet e shtjelluara sa më sipër, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “të pambështetura apo të paarsyetuara”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese këto pretendime duhet shpallur qartazi të pabazuara.

## ii. Përkitazi me pretendimet e tjera

79. Përveç pretendimeve të lartcekura, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të të drejtave kushtetuese të garantuara nga nenet: 3, 21, 24, 23, 29, 37, 38, 40 të Kushtetutës, dhe me nenet 2, 8, 10 të KEDNJ-së.
80. Gjykata rithekson se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së ose ndërlidhja e tyre me një nen tjetër të Kushtetutës nuk nënkupton vetvetiu edhe shkelje të neneve tjera të Kushtetutës ose të KEDNJ-së, nëse më tej nuk argumentohet dhe shtjellohet në nivel kushtetutshmërie se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e tyre. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; dhe së fundmi rastin [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
81. Për këto arsye, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të neneve të lartpërmendura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese të njëjtat duhet shpallur qartazi të pabazuara.

## Përfundime

82. Si përmbledhje, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, Gjykata konkludon se: (I) pretendimet për shkelje të nenit 29 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese këto pretendime shpallën qartazi të pabazuara; (II) pretendimet për shkelje të nenit 30 dhe 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese këto pretendime shpallën si qartazi të pabazuara; (III) pretendimet për shkelje të nenit 27 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese këto pretendime shpallën si qartazi të pabazuara; (IV) pretendimet për shkeljen e nenit 3, 21, 24, 23, 29, 37, 38, 40 të Kushtetutës, dhe nenit 2, 8, 10 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese këto pretendime shpallën si qartazi të pabazuara.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 29 gusht 2023, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- III. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Nexhmi Rexhepi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Gresa Caka-Nimani